



# PENSIONET 2026

## Me qeverinë e Qendrës së Djathtë Pensioni është edhe më larg

Tashmë Ligji Fornero po përkeqësohet. Pas ashpërsimit të kriterëve për të përfitur format e pensionit të parakohshëm, në krahasim me pensionin e pleqërisë, i cili u realizua me Ligjin e Buxhetit të vitit të kaluar, Ligji Financiar për vitin 2026 e ka përkeqësuar edhe më tej situatën. **U hoqën përfundimisht Quota 103 dhe Opzione Donna, ndërsa nga viti i ardhshëm zhblokohet mekanizmi automatik i rritjes së moshës së pensionit.** Prandaj, nga viti 2027 pensioni i pleqërisë do të merret në moshën 67 vjeç e 1 muaj, ndërsa nga viti 2028 në moshën 67 vjeç e 3 muaj. Për pensionin e parakohshëm do të nevojiten 42 vjet e 11 muaj (një vit më pak për gratë) në vitin 2027 dhe 43 vjet e një muaj (një vit më pak për gratë) në vitin 2028. **Kjo rritje nuk do të zbatohet për punët e rënda dhe të lodhshme. Është rikonfirmuar vetëm Ape Sociale duke mbetur në fuqi edhe përkeqësimi i vendosur që në vitin 2024 për kriterin e moshës, në vend të moshës 63-vjeçare, bëhet 63 vjeç e 5 muaj, si dhe do të aplikohet rritja sipas jetëgjatësisë duke filluar nga viti 2027, pra 63 vjet e 6 muaj.**

**Me Ligjin Financiar 2026 vazhdon kështu tendenca për të çmontuar të gjitha format e pensionit të parakohshëm që qeveritë e mëparshme kishin vendosur për të mundësuar një dalje më graduale nga puna, krahasuar me sa parashikon Ligji Fornero.**

### Masa për "kontributdhënësit e pastër"

Punonjësit "kontributdhënës të pastër" janë ata që e kanë pagesën e parë të kontributeve në Sigurimet Shoqërore Publike nga 1 janari 1996. Aktualisht, kushtet për të hyrë në pension për këta punonjës janë: minimumi 20 vite kontribute të derdhura, moshë 64 vjeç e 3 muaj, dhe një pension mujor jo më pak se 3 herë (para qeverisë Meloni ky kufi ishte 2,8 herë) vlera e pensionit social, që në vitin 2026 është 546,24 euro (pra, herë tre: = 1638,72).

### Rritja e vlerës së pragut

Duke filluar nga viti 2030, pragu i shumës për ta përfitur këtë lloj pensioni nuk do të jetë më e barabartë me trefishin e pensionit social, por do të rritet me 3,2 herë.

### Heqja e përdorimit vullnetar të pensionit plotësues për të rritur vlerën e pragut

Ligji Financiar për vitin 2025 kishte parashikuar mundësinë e përdorimit vullnetar të pensionit plotësues privat, duke e kombinuar me pensionin publik, për ta arritur këtë prag. Me fjalë të tjera: pasi të llogaritej pragu mbi bazën e kontributeve të sigurimeve publike, nëse shuma nuk do ta arrinte nivelin e kërkuar, punonjësi mund të shtonte edhe rentën nga fondi i pensionit plotësues, nëse ishte i regjistruar në të. Ky dispozitiv është shfuqizuar nga Ligji Financiar 2026.

### Nëse je punëtor ndërtimi... (shih faqen 4 të fletëpalosjes)

... negociatat kolektive të ndihmojnë shumë. Pse? Së pari, gjatë qeverisë Draghi, sindikatat e ndërtimit, Fillea-CGIL, Filca-CISL dhe FenealUil, arritën të sigurojnë për punëtorët e ndërtimit dhe të sektorit të gurëve uljen e kriterit të kontributeve për të hyrë në Ape Sociale, nga 36 vjeç në **32 vjeç**. Së dyti, sistemi i Casse Edili u mundëson punëtorëve të dalin nga tregu i punës të paktën katër vjet më herët (duke përfshirë edhe periudhën e NASPI-t) para arritjes së moshës/kushtit për pension, duke:

- **plotësuar shumën e NASPI-t**, nga momenti i reduktimit të saj duke filluar nga muaji i 8-të deri në përfundim;
- **garantuar mbështetje të të ardhurave** në nivelin e shumës së CIGO-s, nga përfundimi i NASPI-t deri në arritjen e kriterit për pension.
- **garantuar pagesën e kontributeve vullnetare** nga përfundimi i NASPI-t deri në momentin e përmbushjes së kushteve për pension.





## KUSHTET PËR TË DALË NË PENSION PËR ATA QË NUK MUND TË PËRFITOJNË NGA MËNYRA TË TJERA

TIPOLOGJIA	VITET	KONTRIBUTET
I pleqërisë *	Burra dhe gra: 67 vjeç	20 vjeç
I parakohshëm për burra		42 vjeç e 10 muaj
I parakohshëm për gra		41 vjeç e 10 muaj

\* Të siguruarit nga data 01.01.1996, përveç plotësimit të kriterëve të moshës dhe të viteve të kontributeve, duhet të përmbushin edhe vlerën minimale të pensionit, të barabartë me pensionin social prej 546,24 eurosh.



## TRE TIPOLOGJI TË HERSHËM - OPSIONI GRA - PENSION I PARAKOHSHËM

<b>PUNONJËS TË HERSHËM</b> <b>41 vjet kontribute deri më 31 dhjetor 2026</b>	Kërkohej të jenë derdhur të paktën 12 muaj kontribute para moshës 19-vjeçare. <b>Kujdes: verifikoni mirë kriteret personale!</b>
<b>PENSION I PARAKOHSHËM</b> <b>me shumën e pensionit të barabartë me trefishin e pensionit social</b>	Vlen për punonjësit me 20 vjet kontribute dhe me moshë 64 vjeç, të cilët kanë fituar një pension të barabartë me trefishin e pensionit social (1658,72 euro) dhe që kanë filluar të derdhin kontribute nga data 1 janar 1996 ose konsiderohen të barasvlershëm me to.



# APE SOCIALE NË FUQI DERI MË 31 DHJETOR 2026

TIPOLOGJIA	VJET KONTRIBUTE	MOSHA ANAGRAFIKE	KRITERET
I pushuar nga puna me arsye të justifikuar ose shkak të rëndë	30	63 vjeç e 5 muaj	Duhet të ketë përfunduar NASPI-n
Përfundim i kontratës me kohë të përcaktuar	30	63 vjeç e 5 muaj	1. Duhet të ketë 18 muaj kontribute në 36 muajt para shkëputjes së marrëdhënies së punës; 2. Duhet të ketë përfunduar NASPI-n.
Përfitues i Ligjit 104	38	63 vjeç e 5 muaj	1. Të jetë kujdesur prej të paktën 6 muajsh për një të afërm të nivelit të parë, me bashkëjetesë; 2. Të afërm të nivelit të parë për t'u kujdesur, ose: <ul style="list-style-type: none"> <li>të nivelit të dytë pa bashkëjetesë (gjyshër, nipër, vëllezër, motra)</li> <li>të afërm të nivelit të parë (vjuhërr/vjehër, dhëndurë, nuse)</li> <li>të afërm të nivelit të parë (kunetër)</li> </ul> 3. Në rast subjekti të nivelit të dytë pa bashkëjetesë, duhet të verifikohet që bashkëjetuesit të kenë plotësuar një nga kriteret e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>të kenë mbushur 70 vjeç</li> <li>të kenë patologji invaliduese</li> <li>të kenë vdekur ose të mungojnë</li> </ul>
Invalidë në nivelin 74% e lart	34	63 vjeç e 5 muaj	
Punë të rënda	36	63 vjeç e 5 muaj	Të kenë të paktën 6 vjet punë nga 7, ose 7 vjet nga 10 aktivitete të rënda (shih kutinë më poshtë)
Punë të rënda në ndërtim	32	63 vjeç e 5 muaj	
Gra me 1 fëmijë	29 ose 35 në rast pune të rëndë	63 vjeç e 5 muaj	Ulja e viteve të kontributeve zbatohet për të gjitha tipologjitë pararendëse
Gra me 2 fëmijë	28 ose 34 në rast pune të rëndë	63 vjeç e 5 muaj	

## PUNËTORË ME PUNË TË RËNDA NË NDËRTIM

TIPOLOGJIA	KOD. ISTAT
Punëtorë të specializuar në industrinë nxjerrëse, ndërtim, mirëmbajtje ndërtesash	6
Punëtorë të pakualifikuar minierash, guroresh, ndërtimi dhe profesione të ngjashme	8.4
Operatorë makinerish për lëvizje dheu, vinça ose makineri të lëvizshme shpimi; drejtues mjetesh të rënda dhe kamionësh	7.4
Operatorë të makinave për përzjerjen e betonit	7.2

## JE NJË PUNËTOR NDËRTIMI?

Artizanë, ndërtim (biznes i vogël dhe i mesëm), duhet të shënosh edhe kodin. Kur paraqet kërkesën për njohjen e punës së rëndë, përveçse të tregosh CCNL-në e referencës (Ndërtim – Industri, Ndërtim – Kooperativa, Ndërtim – ISTAT), që i përket detyrës që kryen, i cili gjendet tashmë në formularin përkatës INPS AP 148, siç tregohet në tabelën anësore.

**Kujto se, për certifikimin e kërkuar për Ape Sociale, mund t'i drejtohesh Cassa Edile ku je regjistruar. Për çdo informacion ose sqarim, kontakto përfaqësuesin tënd ose pikën më të afërt të Fillea.**

## PUNËTORË TË PUNËVE TË RËNDA NË IMPIANTE FIKSE

TIPOLOGJIA	KOD. ISTAT
Punëtorë të specializuar në industrinë nxjerrëse, ndërtim, mirëmbajtje ndërtesash	6
Operatorë impiantesh dhe makinerish për nxjerrjen dhe përpunimin fillestar të mineraleve	7.1.1
Operatorë furrash dhe impiantesh të tjera për përpunimin e qelqit, qeramikës dhe materialeve të ngjashme	7.1.3
Operatorë impiantesh për transformimin e drurit dhe prodhimin e letrës	7.1.4
Operatorë mullinjsh dhe makinash përzjerëse	7.1.8.1
Operatorë furrash dhe impiantesh të ngjashme për trajtimin termik të mineraleve	7.1.8.2
Punëtorë gjysmë të kualifikuar të makinerive fikse për prodhim në seri dhe montim, punëtorë për prodhim në seri të produkteve prej betoni dhe artikujve prej druri	7.2
Operatorë makinerish për lëvizje dheu, vinça ose makineri të lëvizshme shpimi dhe ngritjeje; drejtues mjetesh të rënda dhe kamionësh	7.4
Punëtorë të pakualifikuar në industri prodhuese, miniera, gurore dhe profesione të ngjashme	8.4

## JE PUNËTOR NË IMPIANTE PËR PRODHIMIN E DRURIT DHE MATERIALEVE TË NDËRTIMIT?

Kur paraqet kërkesën për njohjen e punës së rëndë, duhet të shënosh kodin ISTAT që i përket detyrës që kryen, i cili gjendet tashmë në formularin përkatës INPS AP 148, siç tregohet në tabelën anësore.

**Për çdo informacion ose sqarim, kontakto përfaqësuesin tënd ose zyrën më të afërt të Fillea dhe drejtoju Inca-CGIL për të gjitha shërbimet që duhet të kërkoh.**



## > APE SOCIALE

brenda datës 31 mars  
2026 ose brenda datës 15  
qershor 2026 dhe jo më  
vonë se 30 nëntor 2026

## > PUNONJËS TË HERSHËM

afati i parë i përfundimit:  
1 mars 2026  
afati i dytë i përfundimit:  
30 nëntor 2026



**Nëse je një punëtor ndërtimi, me Kontratën Kombëtare mund të dalësh në pension të paktën 4 vjet më herët dhe të kesh një pension plotësues më të favorshëm...**

### FONDI I RI PARAPRAK I PENSIONIT

Fondi paraprak i pensionit, i financuar plotësisht nga Casse Edili, u lejon punëtorëve të ndërtimit të dalin nga bota e punës pas përfitimit të NASPI-t, sipas afateve të dhëna më poshtë. Kontributi për pension dhe kompensimi i pagës gjatë këtyre periudhave, deri në momentin e përmbushjes së kushteve për pension, jepen plotësisht nga sistemi bilateral sipas opsioneve më poshtë:

- **deri në 24 muaj** kontribute të derdhura + 24 muaj kompensim i njëkohshëm page (pas periudhës së NASPI-t);
- **deri në 48 muaj** vetëm kontribut vullnetar (për ata që nuk arrijnë 20 vjet kontribute dhe gjithmonë pas periudhës së NASPI-t);
- **deri në 36 muaj** vetëm kompensim pagash (pas periudhës së NASPI-t).

Kompensimi i pagës është i barabartë me maksimumin e Cigo.\*

Gjithashtu, është parashikuar integrimi i NASPI-t, gjithmonë nga Casse Edili, nga momenti i fillimit të reduktimit gradual (décalage) deri në përfundimin e shërbimit. Punëtori, gjatë gjithë periudhës së NASPI-t, do të vazhdojë të marrë të njëjtën shumë që ka marrë nga INPS në muajin e parë të papunësisë.

Shtesa do të paguhet nga Cassa Edile dy herë në muaj.

\* (për vitin 2026 deri në një maksimum prej 1.608,66 eurosh neto në muaj për punëtorin që ka të drejtë për shumën e plotë sipas ligjit)

### PENSIONI PLOTËSUES: MË SHUMË KONTRIBUTE

Është parashikuar një shërbim i ri, duke filluar nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2029

Sistemi bilateral do të derdhë në Fondet e Pensionit Plotësues (Prevedi, Previdenza Cooperativa dhe Fondapi) 1% shtesë mujore për të gjitha shërbimet e punëtorëve që kanë zgjedhur vullnetarisht të kontribuojnë me 1% në Fondet e pensionit.

Pra, **përveç kontributit kontraktual** që ndryshon nga 10 në 20 euro në muaj (sipas nivelit të punës dhe orëve të punuara), **punëtori i ndërtimit që kontribuon me 1% do të marrë 2% të tjera**: 1% nga kompania dhe 1% nga Sistemi bilateral.

#### SHEMBULL PËR NJË PAGË BRUTO 1800 EURO/MUAJ:

1% kontribut vullnetar punëtori:

18 euro

1% kontribut shtesë i kompanisë:

18 euro

1% kuota e Sistemit bilateral:

18 euro

#### TOTALI 54 EURO

**Punëtori vendos 18 euro dhe në Fond derdhen 54 euro në muaj**

(përveç kontributit kontraktual).

Për çdo informacion, mund të kontaktoni degën më të afërt të Fillea Cgil ose të Patronato Inca Cgil

[WWW.FILLEACGIL.NET](http://WWW.FILLEACGIL.NET)



**PATRONATO  
WWW.INCA.IT**